

Nga shkëlqesia e tij,  
shejhu dhe doktori i nderuar:  
*Salih el Feuzan*

# Besimi në melekë dhe ndikimi i tij në jetën e umetit

لسماحة الشيخ الدكتور  
صالح بن فوزان الفوزان

الإيمان بالملائكة و أثره في حياة الأمة

# BESIMI NË MELEKË

DHE NDIKIMI I TIJ NË JETËN E UMETIT

NGA SHEJHU I NDERUAR

SALIH EL FEUZAN

Titulli origjinal: الإيمان بالملائكة وأثره في حياة الأمة

El Imanu bil melaiketi ue etheruhu fi hajatil ummeh

Titulli i plotë: Besimi në melekë dhe ndikimi i tij në jetën e umetit

Përktheu: Besmir Cacani

Redaktor fetar: Idriz Manushi

Publikimi në web: [www.revistamedina.net](http://www.revistamedina.net)

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin

## HYRJE

### **Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.**

Lavdi Allahut, Zotit të krijesave. Salavatet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij. Më pas:

Vërtetë çështja e Imanit (besimit) është madhështore, sepse është baza mbi të cilin qëndron lumturia në këtë botë dhe në tjetrën. Imani është prej gradave më të rëndësishme të fesë. Kur Xhibrili alejhis-selam shkoi tek Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ue sellem, në prezencë të shokëve të tij, e pyeti rreth Islamit, Imanit dhe Ihsanit, dhe i tha: “O Muhamed, më trego për Islamin.” Ai tha: **“Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të vizitosh Qaben nëse ke mundësi.”**<sup>1</sup> Pra, Islamin e ka shpjeguar me veprimin e pesë shtyllave: Shehadeti, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe vizita e Qabes.

Xhibrili tha: “Ke thënë të vërtetën! Më trego për Imanin.” Ai tha: **“Imani është të besosh Allahun, melekët e Tij, Pejgamberët e Tij, Librat e Tij, Ditën e Gjykimit, dhe Kaderin; qoftë i mirë apo i keq.”**<sup>2</sup> Pra, Imanin e ka shpjeguar me besimin në këto gjashtë shtylla: besimi në Allahun, melekët e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit, dhe në Kader; qoftë i mirë apo i keq.

---

<sup>1</sup> Buhariu, tefsirul Kuran (4499); Muslimi, el Iman (10), Nesaiu, el Imanu ue sheraiuhu (4991); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (64); Ahmedi (2/426).

<sup>2</sup> Buhariu, el Iman (50); Muslimi, el Iman (10); Nesaiu, el Imanu ue sheraiuhu (4991); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (64); Ahmedi (2/426).

Tha: “Më trego për Ihsanin.” Ai tha: **“Ihsani është të adhurosh Allahun sikur je duke e parë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”**<sup>3</sup> Pra, ka sqaruar se Ihsani ka një shtyllë të vetme, që është: të adhurosh Allahun sikur je duke e parë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.

Këto janë tre gradat e fesë: Islami, pastaj Imani dhe pastaj Ihsani. Secila gradë ka shtyllat e veta.

Shtylla e diçkaje: d.m.th. mbi të cilën ngrihet. Shtylla e shtëpisë është ajo mbi të cilën ngrihet. Imani ngrihet mbi këto gjashtë shtylla dhe nëse njëra shtyllë bie, atëherë njeriu nuk e beson Allahun, sepse ka humbur njëërën prej shtyllave të Imanit.

Imani ngrihet mbi shtyllat e tij, sikurse edhe ndërtesa ngrihet mbi shtyllat e saja. Këto gjashtë shtylla janë të përmendura në Kuran; herë përmenden së bashku dhe herë pjesërisht. Allahu i Lartësuar thotë:

وَلِكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ

**“Mirëpo bamirësia është kush e beson Allahun, Ditën e Gjykimit, melekët, librat dhe pejgamberët.”**<sup>4</sup> Allahu xhel-le ue ala’ ka përmendur në këtë ajet fisnik pesë prej shtyllave të Imanit. Allahu i Lartësuar thotë:

---

<sup>3</sup> Buhariu, tefsirul Kuran (4499); Muslimi, el Iman (10); Nesaiu, el Imanu ue sheraiuhu (4991); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (64); Ahmedi (2/426).

<sup>4</sup> El Bekare: 177.

آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ ۚ كُلُّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ  
بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۚ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ

**“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, melekët e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij.”<sup>5</sup>** Ka përmendur katër shtylla, ndërsa të tjera herë përmend dy prej tyre: besimin në Allahun dhe Ditën e Fundit. Allahu i Lartësuar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَادُوا وَالنَّصَارَى وَالصَّابِئِينَ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

**“Ata që besojnë (në Kuran), çifutët, të krishterët dhe sabi’inët<sup>6</sup> - kushdo prej tyre që beson Allahun dhe Ditën e Fundit.”<sup>7</sup>** Në këtë ajet ka përmendur dy shtylla: besimin në Allahun dhe Ditën e Fundit. Sa i përket besimit në kader, Allahu i Lartësuar e ka përmendur në thënien e Tij:

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ

**“Vërtetë Ne çdo gjë e kemi krijuar me kader (masë të paracaktuar).”<sup>8</sup>** Dhe e ka përmendur në thënien e Tij:

وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا

**“Ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet.”<sup>9</sup>**

---

<sup>5</sup> El Bekare: 285.

<sup>6</sup> Një sekt i krishterë. (shp)

<sup>7</sup> El Bekare: 62.

<sup>8</sup> El Kamer: 49.

## DOMETHËNIA E BESIMIT NË MELEKË

Tema në të cilën jemi është: besimi në melekë, e cila është shtyllë prej shtyllave të besimit, kuptimi i së cilës është: besimi në egzistencën e tyre dhe në punët që ata i bëjnë në këtë Gjithësi.

Melekët janë krijesa prej krijesave të Allahut që i ka krijuar për adhurimin e Tij, dhe për zbatimin e urdhërave të Tij në Gjithësi. Allahu i dërgon melekët që të zbatojnë urdhërin e Tij. Ata janë krijesa prej botës së fshehtë të cilët nuk i shikojmë, mirëpo i besojmë me besim të prerë që nuk pranon dyshim, sepse Allahu subhanehu ue teala ka lajmëruar për ta, sikurse ka lajmëruar për ta Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, në mënyrë të prerë që na bën t'i besojmë.

---

<sup>9</sup> El Furkan: 2.

## NGA ÇFARË JANË KRIJUAR MELEKËT?

Melekët janë krijuar nga nuri (drita), sikurse ka ardhur në hadith, se Allahu subhanehu ue teala i ka krijuar melekët nga nuri, shejtanët nga zjarri dhe njerëzit nga balta.



## CILËSITË E MELEKËVE

❖ **E para:** ata janë ushtria më madhështore e Allahut nga bota e fshehtë; numrin, formën dhe fizionominë e tyre e di vetëm Allahu i Lartësuar.

Prej cilësive të tyre: e para: ata janë ushtria më madhështore e Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

وَلِلَّهِ جُنُودُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

**“Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës.”**<sup>10</sup>  
Ndërsa kur ka përmendur rojtarët e Zjarrit, ka thënë:

عَلَيْهَا تِسْعَةَ عَشَرَ

**“Atij i rrinë roje nëntëmbëdhjetë (melekë).”**<sup>11</sup> Allahu i Lartësuar gjithashtu ka thënë:

وَمَا جَعَلْنَا أَصْحَابَ النَّارِ إِلَّا مَلَائِكَةً، وَمَا جَعَلْنَا عِدَّتَهُمُ إِلَّا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا

**“Ne kemi bërë rojtarë të Zjarrit vetëm melekë dhe numrin e tyre e kemi bërë sprovë për mosbesimtarët.”**<sup>12</sup>

Rojtarët e Zjarrit, d.m.th. se për Xhehenemin janë nëntëmbëdhjetë melekë, të cilët e ruajnë, kujdesen, ndezin zjarrin dhe kryejnë punët e tij.

---

<sup>10</sup> El Fet’h: 4.

<sup>11</sup> El Muddethir: 30.

<sup>12</sup> El Muddethir: 31.

Disa mosbesimtarë, kur dëgjuan për numrin e rojtarëve të Zjarrit, ata sikur e nënçmuan këtë numër dhe njëri tha: unë mjaftoj për ju kundër tyre, d.m.th. që nëse ai hyn në Zjarr, do të ndeshet me ta, do t'i mundë dhe do të dalë nga Zjarri. Ai po tallej dhe lodronte, mirëpo Allahu i Lartësuar iu kundërpërgjigj me thënien:

وَمَا جَعَلْنَا أَصْحَابَ النَّارِ إِلَّا مَلَائِكَةً

**“Ne kemi bërë rojtarë të Zjarrit vetëm melekë.”**<sup>13</sup> Pra, nuk janë prej njerëzve.

Nëse ky pretendon për veten e vet se është i fortë, dhe se mund t'i bëjë ballë një numër prej njerëzve, atëherë ai nuk mund të përballojë asnjë prej melekëve. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَمَا جَعَلْنَا أَصْحَابَ النَّارِ إِلَّا مَلَائِكَةً ۖ وَمَا جَعَلْنَا عِدَّتَهُمْ إِلَّا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا لِيَسْتَيْقِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ وَيَزِدَّادَ الَّذِينَ آمَنُوا إِيمَانًا ۖ وَلَا يَرْتَابَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ وَالْمُؤْمِنُونَ ۖ وَلِيَقُولَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ وَالْكَافِرُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا ۗ

**“Ne kemi bërë rojtarë të Zjarrit vetëm melekë”,**<sup>14</sup> d.m.th. nuk i ka bërë prej njerëzve apo xhindëve, **“dhe numrin e tyre e kemi bërë sprovë për mosbesimtarët, me qëllim që të binden ata që u është dhënë Libri e t’u shtohet besimi atyre që besojnë; që të mos dyshojnë ata që u është dhënë Libri dhe besimtarët e vërtetë, dhe që të thonë ata që kanë sëmundjen e dyshimit në zemër”**<sup>15</sup> d.m.th. mosbesimtarët: **“Ç’ka dashur të**

<sup>13</sup> El Muddethir: 31.

<sup>14</sup> El Muddethir: 31.

<sup>15</sup> El Muddethir: 31.

**thotë Allahu me këtë shembull?”<sup>16</sup>** Ata gënjejnë dhe këtë numër melekësh e shohin si të vogël. Si mundet ky Zjarr i madh, në të cilin janë gjithë këto krijesa, mos të ketë më shumë se nëntëmbëdhjetë melekë.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَا جَعَلْنَا عِدَّتَهُمْ إِلَّا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا

**“Dhe numrin e tyre e kemi bërë sprovë për mosbesimtarët.”<sup>17</sup>** Vetëm Allahu e di madhështinë e melekëve, vetëm Allahu e di sa ka prej ushtrive të qiejve dhe Tokës, nuk e dinë mosbesimtarët dhe as ndokush tjetër.

❖ **E dyta:** fizionomia e tyre është madhështore.

Allahu i Lartësuar e ka përmendur këtë gjë në thënien e Tij:

الْحَمْدُ لِلَّهِ فَاطِرِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ جَاعِلِ الْمَلَائِكَةِ رُسُلًا أُولِي أَجْنِحَةٍ مَّثْنَىٰ وَثُلَاثَ ۖ وَرُبَاعَ ۗ  
يَرِيدُ فِي الْخَلْقِ مَا يَشَاءُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

**“Lavdi Allahut, Krijuesit të qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë melekët të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë.”<sup>18</sup>** D.m.th. ka prej tyre që kanë dy krahë, ka me tre, me katër, dhe ka prej tyre me më shumë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka parë Xhibrilin me gjashtëqind krahë, ku secili krah kishte zënë

---

<sup>16</sup> El Muddethir: 31.

<sup>17</sup> El Muddethir: 31.

<sup>18</sup> Fatir: 1.

horizontin. Ky është një prej melekëve, dhe Allahu e ka cilësuar se është shumë i fortë. Allahu i Lartësuar ka thënë::

عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَى

**“Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm.”**<sup>19</sup>  
D.m.th. Xhibrili alejhis-salam. Allahu i Lartësuar ka thënë::

ذُو مِرَّةٍ فَاسْتَوَى

**“I bukur dhe i fuqishëm, që iu paraqit qartë.”**<sup>20</sup>

❖ **E treta:** melekët kanë fuqi shumë të madhe me lejen e Allahut.

Prej argumenteve të fuqisë së tyre, është se po ta urdhëronte Allahu ndonjërin prej tyre të ulërinte në këtë botë, të gjitha krijesat do të vdisnin. Kështu ka ndodhur me popullin e Themudit, të cilët i mbyti ulërima. Xhibrili i ulëriti një herë të vetme:

إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ صَيْحَةً وَاحِدَةً فَكَانُوا كَهَشِيمِ الْمُخْتَطِرِ

**“Ne dërguam mbi ta një ulurimë të vetme e ata u bënë si sana e copëtuar (shkelur).”**<sup>21</sup> Zemrat i lanë, vdekën dhe u bënë si sana e copëtuar (shkelur).

---

<sup>19</sup> En-Nexhm: 5.

<sup>20</sup> En-Nexhm: 6.

Arabët e kishin zakon që kur hynin në shtëpi, të mblidhni drunj, t'i jepnin barë deleve dhe bagëtive. Ky barë thahej dhe bëhej sanë, dhe populli i Themudit me gjithë fuqinë dhe pushtetin që kishin, u bënë si sana e copëtuar në plemë si rrjedhojë e një ulërimi të Xhibrilit.

Allahu e ka urdhëruar Xhibrilin që të ngrejë popullin e Lutit, që janë shtatë qytete me njerëz, me ndërtesa, orendi dhe kafshë. Ai i mbajti mbi njërin krah të tij, i ngriti saqë melekët e dëgjuan të lehurën e qenëve dhe këndimin e gjelave të tyre, më pas i ktheu përmbys. Allahu e shembi tokën bashkë me ta.

Ky është një shembull i fuqisë së melekëve, alejhimus-selam.

Israfilin alejhis-selam është i ngarkuari për t'i fryrë surit, dhe suri është: briri i cili i mbledh gjithë shpirtrat e njerëzve, nga i pari deri tek i fundit. Israfilin do t'i bie një herë të vetme surit, dhe shpirtrat dalin nga ky sur dhe shkojnë tek trupat e tyre. Kjo është fryerja e ringjalljes, dhe para saj është fryerja e vdekjes, nga ku vdesë çdokush që është në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që dëshiron Allahu. Allahu az-ze ue xhel-le thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ

**“Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu.”<sup>22</sup>**

---

<sup>21</sup> El Kamer: 31.

<sup>22</sup> Ez-Zumer: 68.

Më pas i fryhet edhe një herë, e kjo është fryerja e ringjalljes:

فَإِذَا هُمْ قِيَامٌ يَنْظُرُونَ

**“Dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.”<sup>23</sup>**

Ky është një prej melekëve të Gjithëmëshirshmit, e kjo është një prej punëve të tij që e urdhëron Allahu. Pra, melekët janë krijesa madhështore prej krijesave të Allahut, të cilët i ka krijuar që ta adhurojnë dhe zbatojnë urdhërat e Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë::

بَلْ عِبَادٌ مُّكْرَمُونَ (26) لَا يَسْبِقُونَهُ بِالْقَوْلِ وَهُمْ بِأَمْرِهِ يَعْمَلُونَ (27) يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ

وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يَشْفَعُونَ إِلَّا لِمَنْ ارْتَضَىٰ وَهُمْ مِنَ حَشِيَّتِهِ مُشْفِقُونَ

**“Jo, ata (melekët) janë adhurues të nderuar (të Allahut). Ata nuk flasin para (Fjalës së) Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij. Ai e di se ç’ka para tyre (ç’kanë vepruar) dhe ç’ka pas tyre (çfarë do të veprojnë), ndërsa ata ndërmjetsojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë (se mos i ndëshkon).”<sup>24</sup>** Ky është përshkrim i melekëve.

---

<sup>23</sup> Ez-Zumer: 68.

<sup>24</sup> El Enbija’: 26-28.

## PUNËT ME TË CILAT JANË NGARKUAR MELEKËT

Melekët kanë punë, ku secili prej tyre është i ngarkuar me një të tillë që nuk e lë pa bërë, përkundrazi ai e bën atë, e zbaton urdhërin e Allahut dhe nuk e kundërshton. Allahu i Lartësuar thotë:

عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ غِلَاظٌ شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ

**“Atë (Zjarrin) e mbikëqyrin melekë të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhërat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”<sup>25</sup>**

Prej punëve të tyre:

❖ **Së pari:** ata që kujdesen për Xhehenemin.

Janë ata të cilët quhen “Rojtarë të Xhehenemit”, d.m.th. janë të ngarkuar me Zjarrin dhe ndëshkimin e banorëve të tij.

❖ **Së dyti:** ka prej melekëve që janë të ngarkuar me bartjen e Arshit të Allahut subhanehu ue teala. Allahu i Lartësuar thotë:

الَّذِينَ يَحْمِلُونَ الْعَرْشَ وَمَنْ حَوْلَهُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيُؤْمِنُونَ بِهِ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِلَّذِينَ آمَنُوا  
رَبَّنَا وَسِعْتَ كُلَّ شَيْءٍ رَّحْمَةً وَعِلْمًا فَاغْفِرْ لِلَّذِينَ تَابُوا

**“Ata (melekët) që e mbajnë Arshin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata kërkojnë falje për besimtarët, duke thënë: “O Zoti ynë, Ti**

---

<sup>25</sup> Et-Tahrim: 6.

përfshin çdo gjë me mëshirën dhe diturinë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar.”<sup>26</sup> Allahu i Lartësuar thotë:

وَيَحْمِلُ عَرْشَ رَبِّكَ فَوْقَهُمْ يَوْمَئِذٍ ثَمَانِيَةً

“Kurse tetë prej tyre (melekëve) do të mbajnë Arshin e Zotit tënd.”<sup>27</sup>

### **Numri i bartësve të Arshit:**

Bartësit e Arshit janë katër, më pas në Ditën e Kiametit numri i tyre shtohet dhe bëhet tetë. Arshi është krijesa më e madhe dhe më madhështore e Allahut, të cilin e mbajnë tetë melekë Ditën e Kiametit, gjë e cila tregon për fuqinë e melekut, sepse ata mbajnë këtë Arsh madhështor që është krijesa më e madhe dhe më madhështore. E gjithë kjo tregon për fuqinë dhe fizionominë e tyre të madhe.

❖ **Së treti:** ka prej tyre që janë të ngarkuar me Shpalljen, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

يُنزِلُ الْمَلَائِكَةَ بِالرُّوحِ مِنْ أَمْرِ عَلِيٍّ مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ أَنْ أَنْذِرُوا أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاتَّقُونِ

“Ai dërgon melekët (Xhibrilin) me shpirt (Shpallje) kujt të dojë prej robërve të Tij (duke u thënë): “Paralajmëroni se s’ka të adhurar me të drejtë përveç Meje, prandaj të më kini frikë Mua.”<sup>28</sup>

---

<sup>26</sup> Gafir: 7.

<sup>27</sup> El Hakkah: 17.

<sup>28</sup> En-Nahl: 2.



“Shpirt” ka kuptimin Shpallje. Thuhet “shpirt” sepse i gjallëron zemrat ashtu sikur shiu gjallëron tokën, dhe ashtu si shpirti i krijuar i gjallëron trupat e krijesave.

“Shpirt” ka kuptimin “Kuran”, Allahu i Lartësuar i thotë Pejgamberit të Tij:

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحًا مِّنْ أَمْرِنَا ۗ مَا كُنتَ تَدْرِي مَا الْكِتَابُ وَلَا الْإِيمَانُ

**“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty shpirt (Kuran) me urdhërin dhe vullnetin Tonë.”**<sup>29</sup> “Shpirt” do të thotë “Kuran”, sepse Kurani i gjallëron zemrat e besimtarëve. Ashtu siç gjallërohet toka me shi, ashtu edhe zemrat e besimtarëve gjallërohen me Kuran.

“Shpirt” vjen edhe me kuptimin se është Xhibrili alejhis-selam, i cili është meleku më i madh, më i miri dhe i nderuari. Ai ka zbritur me Kuranin nga Allahu për tek Muhamedi sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, Allahu i Lartësuar ka thënë:

نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ (193) عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ (194) بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُّبِينٍ

**“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhibrili), në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.”**<sup>30</sup> Pra, Xhibrili ia ka zbritur Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem Kuranin, ndërsa ai ia ka përcjellë umetit të vet. Në një ajet tjetër thuhet:

---

<sup>29</sup> Esh-Shura: 52.

<sup>30</sup> Esh-Shuara’: 193-195.

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ آمَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ

**“Thuaj: “Atë (Kuranin) e ka zbritur Ruhul Kudus nga Zoti yt.”<sup>31</sup> D.m.th. e ka zbritur Xhibrili dhe ai është Ruhul Kudus.**

### **Cilësitë e Xhibrilit alejhis-selam**

Allahu i Lartësuar e ka cilësuar Xhibrilin me cilësi madhështore: Ai ka thënë:

فَلَا أُفْسِئُ بِالْحَنَسِ (15) الْجَوَارِ الْكُنَّسِ (16) وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ (17) وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ (18) إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ (19) ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ (20) مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ

**“Betohem për ata (planete) që tërhiqen, që lindin e perëndojnë, për natën kur bie terri e për agimin kur nis të zbardhë, se ky (Kuran) është Fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari fisnik (prej Xhibrilit), që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Arshit, e që është i dëguar atje dhe besnik.”<sup>32</sup>**

**Cilësia e parë:** fuqia, Allahu i Lartësuar ka thënë:

ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ

**“Që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Arshit.”<sup>33</sup>**  
Allahu është Zoti i Arshit, ndërsa **“që zotëron fuqi”<sup>34</sup>**, është cilësi e Xhibrilit alejhis-selam.

---

<sup>31</sup> En-Nahl: 102.

<sup>32</sup> Et-Tekuir: 15-21.

<sup>33</sup> Et-Tekuir: 20.

**Cilësia e dytë:** ka pozitë: “**dhe pozitë të lartë**”,<sup>35</sup> d.m.th. që ka pozitë tek Allahu që askush veç tij nuk mund ta arrijë.

**Cilësia e tretë:** bindja: “**e që është i dëgjuar atje**”,<sup>36</sup> të gjithë melekët i binden me urdhër prej Allahut të Lartësuar.

**Cilësia e katërt:** besnikëria: “**dhe besnik**”,<sup>37</sup> d.m.th. është besnik në Shpallje, që nuk shton në fjalë dhe as mangëson, mirëpo e përcjell ashtu siç ia ka shpallur Allahu.

**Shikimi i Xhibrilit alejhis-selam nga ana e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.**

Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ (22) وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ

“**Shoku juaj (Muhamedi) nuk është i marrë**”<sup>38</sup> sikurse kanë thënë mosbesimtarët. “**Ai e ka parë atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë.**”<sup>39</sup>

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e ka parë Xhibrilin në horizont dy herë:

**Hera e parë:** ka qënë në fushën e Mekës. Ai ka ngritur kokën dhe ka parë Xhibrilin në qiell me gjashtëqind krahë, çdo krah e zinte horizontin.

---

<sup>34</sup> Et-Tekuir: 20.

<sup>35</sup> Et-Tekuir: 20.

<sup>36</sup> Et-Tekuir: 21.

<sup>37</sup> Et-Tekuir: 21.

<sup>38</sup> Et-Tekuir: 22.

<sup>39</sup> Et-Tekuir: 23.

## Hera e dytë:

وَلَقَدْ رَآهُ نَزْلَةً أُخْرَىٰ (13) عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَا

**“Ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, te Sidretul Muntehe.”**<sup>40</sup> Natën e Israsë dhe Miraxhit, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e ka parë Xhibrilit në fizionominë e tij që e ka krijuar Allahu në qiej.

Këto janë prej cilësive të Xhibrilit alejhis-selam. Po ashtu Allahu i Lartësuar thotë:

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ

**“Vërtetë ky (Kuran) është vërtet fjalë e (përcjellë prej) një të Dërguari të nderuar (Xhibrilit).”** D.m.th. Kurani Fjala e Allahut të Lartësuar, mirëpo në këtë ajet është përkatësuar (si përcjellje) e Xhibrilit sepse ai ia ka përcjellë Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ai ia ka thënë Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke e përcjellë nga Allahu. Kurani është Fjala e Allahut, dhe fjala i përkatësohet atij që e ka thënë fillimisht, dhe nuk i përkatësohet atij që e përcjell, mirëpo në këtë rast i është përkatësuar Xhibrilit nga aspekti i përcjelljes.

❖ **Së katërti:** ka prej melekëve që janë të ngarkuar me punë të tjera.

1. Mikaili është i ngarkuar me shiun që zbret nga qielli. Ai e sjell dhe e zbret aty ku e ka urdhëruar Allahu sunbhanehu ue teala.

---

<sup>40</sup> En-Nexhm: 13-14.

2. Israfili është i ngakuar t'i fryjë surit kur të dëshirojë Allahu ringjalljen e krijesave nga varret e tyre. Trupat do të dalin nga varret, do të plotësohen dhe do të mbesë vetëm shpirti, në atë moment Israfili i fryn surit me urdhër prej Allahut, dhe shpirtrat do të shkojnë nëpër trupa, të cilat do të mbijnë dhe dalin nga këto varre, e më pas do të shkojnë ku t'i urdhërojë Allahu. Allahu i Lartësuar thotë:

يَوْمَ يُخْرِجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ سِرَاعًا كَأَنَّهُمْ إِلَىٰ نُصُبٍ يُوفِضُونَ

**“Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një podi.”<sup>41</sup>** Po ashtu, Allahu i Lartësuar ka thënë:

حُشْعًا أَبْصَارُهُمْ يَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ كَأَنَّهُمْ جَرَادٌ مُّنتَشِرٌ (7) مُهْطِعِينَ إِلَى الدَّاعِ ۗ يَقُولُ الْكَافِرُونَ هَذَا يَوْمَ عَسِيرٍ

**“Do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë, duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Atëherë, mosbesimtarët do të thonë: “Kjo është ditë e vështirë!”<sup>42</sup>**

Këta tre melekë janë të ngarkuar me punë të jetës: Xhibrili është i ngarkuar me Shpalljen që është jetë për zemrat, Mikaili është i ngakuar me shiun që është jetë për tokën pas vdekjes së saj, kurse Israfili është i ngarkuar me fryerjen në sur që është jetë për trupat. Për këtë, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, kur ngrihej natën, pasi bënte tekbinin fillestar për namaz, thoshte në

<sup>41</sup> El Mearixh: 43.

<sup>42</sup> El Kamer: 7-8.

hapje: **“O Allah! O Zoti i Xhibrit, Mikailit dhe Israfil! O Krijuesi i qiejve dhe Tokës...”**<sup>43</sup> deri në fund të lutjes.

Këta janë melekët më të mëdhenj, për shkak të punëve të tyre të mëdha.

❖ **Së pesti:** ka melekë të ngarkuar me fetusin në barkun e gruas.

Sikure transmetohet në hadithin e Abdullah ibën Mes’udit se ka thënë: Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na ka treguar dhe ai është besniku që i besohet fjala: **“Vërtetë ndonjëri prej jush formohet në barkun e nënës së tij si ujë (nutfeh) për dyzet ditë, më pas formohet si copë mishi i varur (alekah) për dyzet të tjera, më pas formohet si mish i përtypur (mudgah) për dyzet të tjera, më pas i dërgohet meleku i cili i fryn shpirtin dhe urdhërohet me katër gjëra: t’i shkruajë rriskun, vdekjen, veprat e tij, dhe i lumtur apo i trishtuar.”**<sup>44</sup>

Allahu e dërgon këtë melek për këtë detyrë madhështore.

❖ **Së gjashti:** ka melekë të ngarkuar me marrjen e shpirttrave.

Kur afati i jetës përfundon, vjen meleku i vdekjes. Allahu i Lartësuar ka thënë:

---

<sup>43</sup> Muslimi, salatul musafirin ue kasruha (770); Tirmidhiu, ed-da’uaat (3420); Nesaiu, kijamul-lejli ue tetauau en-nehar (1625); Ibën Maxheh, ikametus-salah ues-sunnetu fijha (1357); Ahmedi (6/156).

<sup>44</sup> Buhariu, bed’ul khalk (3036); Muslimi, el kader (2643); Tirmidhiu, el kader (2137); Ebu Daudi, es-Sunneh (4708); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (76); Ahmedi (1/430).

قُلْ يَتَوَفَّاكُمْ مَلَكُ الْمَوْتِ الَّذِي وُكِّلَ بِكُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ

**“Thuaju: “Shpirtin do t’jua marrë meleku i vdekjes.”<sup>45</sup>**

Meleku i vdekjes ka ndihmëtarët e tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِذَا جَاءَ أَحَدَكُمْ الْمَوْتُ تَوَفَّتْهُ رُسُلُنَا وَهُمْ لَا يُفْرِطُونَ (61) ثُمَّ رُدُّوْا إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمْ الْحَقِّ ؕ

**“Kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin (melekët), duke mos bërë kurrfarë lëshimi. Pastaj të gjithë do të kthehen tek Allahu, Zoti tyre i vërtetë.”<sup>46</sup>** Vdekja i është përkatësuar melekëve, melekut të vdekjes dhe Allahut. Allahu i Lartësuar ka thënë:

اللَّهُ يَتَوَفَّى الْأَنْفُسَ حِينَ مَوْتِهَا

**“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes.”<sup>47</sup>** Vdekja i është përkatësuar Allahut sepse Ai subhanehu ue teala ka urdhëruar për të. Vdekja i është përkatësuar melekëve sepse ata e ndërmarrin atë punë, duke e mbledhë shpirtin dhe duke e drejtuar nga trupi i njeriut për në fyt. Po ashtu, vdekja i është përkatësuar melekut të vdekjes:

قُلْ يَتَوَفَّاكُمْ مَلَكُ الْمَوْتِ الَّذِي وُكِّلَ بِكُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ

---

<sup>45</sup> Es-Sexhdeh: 11.

<sup>46</sup> El En’am: 61-62.

<sup>47</sup> Ez-Zumer: 42.

**“Thuaju: “Shpirtin do t’jua marrë meleku i vdekjes”,<sup>48</sup>** sepse ai është i ngarkuar që ta marrë shpirtin, kur ai mblidhet në fazën e fundit.

❖ **Së shtati:** ka melekë që janë të ngarkuar me shënimin dhe ruajtjen e veprave të njeriut.

Sikurse thuhet në hadith: **“Ndërrohen për ju melekë natën dhe melekë ditën.”<sup>49</sup>** Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ (10) كِرَامًا كَاتِبِينَ (11) يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ

**“Vërtetë mbi ju ka rojtarë (melekë që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.”<sup>50</sup>**

### **Cdo njeri ka dy melekë bashkë me të:**

Secili prej nesh ka dy melekë bashkë me të që janë të ngarkuar për të. Njëri melek është në të djathtë dhe shkruan veprat e mira, dhe një tjetër është në të majtë dhe shkruan veprat e këqija. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِذْ يَتَلَفَّى الْمُتَلَفِّيَانِ عَنَ الْيَمِينِ وَعَنَ الشِّمَالِ قَعِيدٌ (17) مَا يَلْفِظُ مِن قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ

---

<sup>48</sup> Es-Sexhdeh: 11.

<sup>49</sup> Buhariu, mauakit es-salah (530), Muslimi, el mesaxhid ue mauadius-salah (632), Nesaiu, es-salah (485), Ahmedi (2/486), Maliku, en-nidau lis-salah (413).

<sup>50</sup> El Infitar: 10-12.



**“Dy melekë i rrinë atij, njëri nga e djathta dhe njëri nga e majta, dhe për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”<sup>51</sup>** Këta rojtarë e shoqërojnë njeriun në udhëtim, në ndenje, në të gjitha gjëndjet e tij, në namaz dhe në sexhde të tij. Ata e shoqërojnë dhe nuk i ndahen, përveçse në raste të veçanta: sikur kryerja e nevojës, mirëpo ata i shkruajnë fjalët dhe veprat e tij.

### **Melekët shkruajnë nijetet dhe qëllimet:**

Ka argumente se melekët shkruajnë nijetet dhe qëllimet që njeriu ka në zemër dhe çfarë ka nijet të bëjë. Andaj, njeriu shpërblehet për nijetin e mirë, sepse është vepër e zemrës, dhe ndëshkohet për nijetin e keq, sepse është vepër e zemrës.

Këta melekë janë të ngarkuar me njeriun që nga koha kur arrin moshën e pjekurisë dhe derisa të ndërrojë jetë. Ata shkruajnë veprat që njeriu i ka bërë gjatë jetës, qofshin nijete, vepra, fjalë etj.

### **Pozita e namazit të sabahut dhe të iqindisë në mesin e namazeve të tjera:**

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ndërrohen për ju melekë natën dhe melekë ditën, të cilët bashkohen në namazin e iqindisë dhe të sabahut.”<sup>52</sup>** Për këtë arsye, këto dy namaze janë namazet me të mira. Allahu i Lartësuar ka thënë:

---

<sup>51</sup> Kaf: 17-18.

<sup>52</sup> Buhariu, mauakit es-salah (530); Muslimi, el mesaxhid ue mauadius-salah (632); Nesaiu, es-salah (485); Ahmedi (2/486); Maliku, en-nidau lis-salah (413).

وَقُرْآنَ الْفَجْرِ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا

**“Dhe lexo Kuran në sabah”,**<sup>53</sup> d.m.th. në namazin e sabahut, **“vërtetë, leximi në sabah është i dëshmuar.”**<sup>54</sup> Janë prezentë melekët e natës dhe të ditës. Ata bashkohen në namazin e sabahut bashkë me muslimanët dhe dëgjojnë Kuranin që lexohet në namaz. Ata bashkohen në namazin e iqindisë dhe Allahu i pyet – kurse Ai është më i Dituri – se si i latë robërit e Mi? Thonë: “I gjetëm duke u falë, i lamë duke u falë”, d.m.th. ata zbritën ndërsa ne po falnim namazin e iqindisë, e prezantuan namazin bashkë me ne, u ngjitën dhe ne po falnim sabahun.

Për këtë, namazi i iqindisë është namazi i mesëm, për të cilin Allahu ka nxitur për të dhe ka thënë:

حَافِظُوا عَلَيَّ الصَّلَاةِ وَالصَّلَاةِ الْوُسْطَىٰ

**“Falini rregullisht namazet, e sidomos atë të mesmin.”**<sup>55</sup> D.m.th. namazin e iqindisë, sepse atë e prezantojnë melekët e natës dhe të ditës (të ngarkuarit për shënimin e veprave të njeriut).

### **Thirrje për gjynahqarët:**

Ku janë ata të cilët nuk prezantojnë namazin e sabahut, flejnë në krevatet e tyre dhe nuk prezantojnë në këtë tubim bashkë me melekët e të Gjithëmëshirshmit në çdo natë?! Ku melekët e të

---

<sup>53</sup> El Isra': 78.

<sup>54</sup> El Isra': 78.

<sup>55</sup> El Bekare: 238.

Gjithëmëshirshmit lajmërojnë për ta tek *el Meleul Eala*<sup>56</sup>: “I gjetëm duke u falë, i lamë duke u falë.”

Çfarë përfitoi ai që nuk prezantoi namazin e sabahut dhe i dha përparësi gjumit? Çfarë përfitoi ai që përtoi në namazin e iqindisë dhe i dha përparësi gjumit apo punëve të tjera?

Në hadith është transmetuar: **“Kujt i ikën namazi i iqindisë, është sikur t’i jenë hequr familja dhe pasuria e tij.”**<sup>57</sup> Kurse në një hadith tjetër: **“Atëherë i janë shkatërruar punët e tij.”**<sup>58</sup> D.m.th. atij që i del nga koha e saj. Nëse i ka dalë namazi nga koha, atëherë i ka ikur namazi.

❖ **Së teti:** ka melekë që janë të ngarkuar me mbrojtjen e njeriut nga rreziqet.

Njeriu ecën nëpër rreziqe, mirëpo Allahu ka ngarkuar melekët e Tij që ta mbrojnë nga rreziqet që i ka caktuar në këtë jetë. Kjo tokë mbi të cilën njeriu jeton, ka rreziqe, ka kafshë grabitqare, ka gjarpërinj, akrepë, ka njerëz zullumqarë, kërcënues dhe të padrejtë, mirëpo Allahu i ka bërë këta melekë përcjellës dhe mbrojtës. Allahu i Lartësuar ka thënë:

لَهُ مُعَقَّبَاتٌ مِّن بَيْن يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ

---

<sup>56</sup> Krijesat që janë lart tek Allahu. (shp)

<sup>57</sup> Buhariu, kitabul menakib (3407); Muslimi, kitabul mesaxhid ue mauadius-salah (636); Tirmidhiu, kitabu es-salah (175); Nesaiu, kitabu es-salah (479); Ibën Maxheh, kitabu es-salah (685); Ahmedi (2/102 dhe 2/145); Maliku, kitabu vukut es-salah (21); Darimiu, kitabu es-salah (1230 dhe 1231).

<sup>58</sup> Buhariu, mauakit es-salah (528); Nesaiu, es-salah (474); Ibën Maxheh, es-salah (694); Ahmedi (5/357).

**“Njeriu ka përcjellës (melekë), para tij dhe pas tij.”**<sup>59</sup> E mbrojnë atë me urdhër prej Allahut. Përderisa Allahu i ka shkruar të jetë mirë, këta melekë e mbrojnë që mos ta dëmtojë askush atë. E kur t’i vijë vdekja e tij, me lejen e Allahut, këta melekë largohen prej tij; njëri nga përpara dhe tjetri nga mbrapa.

إِنَّ اللَّهَ لَا يُعَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُعَيِّرُوهُمَا بِأَنفُسِهِمْ ۗ وَإِذَا أَرَادَ اللَّهُ بِقَوْمٍ سُوءًا فَلَا مَرَدَّ لَهُ ۗ

**“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetet e tyre. Kur Ai dëshiron ta ndëshkojë një popull, askush nuk mund ta pengojë Atë.”**<sup>60</sup> Nëse vjen caktimi i Allahut dhe Allahu dëshiron që të vdesë ky njeri, atëherë melekët që e përcjellin dhe e mbrojnë largohen prej tij, sepse ata nuk mund të largojnë prej njeriut urdhërin e Allahut. Këta janë melekët përcjellës (mbrojtës).

❖ **Së nënti:** ka melekë që janë të ngarkuar në këtë Gjithësi me punë që i di vetëm Allahu.

Ka melekë të ngarkuar me detërat, melekë të ngarkuar me lumenjt, melekë të ngarkuar me erërat dhe ka të tjerë të ngarkuar me punë të shumta.

Kjo Gjithësi, në të cilën ndodhin gjithë këto gjëra njëra pas tjetrës, të gjitha këto ndodhin me caktimin e Allahut subhanehu ue teal, ndërsa melekët zbatojnë atë për të cilën i ka urdhëruar Ai.

---

<sup>59</sup> Er-Ra’d: 11.

<sup>60</sup> Er-Ra’d: 11.

## OBLIGUESHMËRIA E BESIMIT NË MELEKË DHE NË TË GJITHA PUNËT E TYRE

Ka prej melekëve që Allahu na i ka treguar me emër, sikur Xhibrili, Mikaili, Israfilu dhe Maliku rojtari i Zjarrit. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَنَادُوا يَا مَالِكُ لِيَقْضِ عَلَيْنَا رَبُّكَ ۗ

**“Ata do të thërrasin: “O Malik! (Më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!”**<sup>61</sup> Dhe ka prej tyre që Allahu nuk na i ka treguar me emër, mirëpo ne i besojmë të gjithë melekët e Allahut azze ue xhel-le; ata që ia dimë emrin dhe ata që nuk ia dimë. Po ashtu i besojmë punët që ata i bëjnë me urdhër prej Allahut të Lartësuar.

Ka melekë të cilët bëjnë adhurim në qiej gjithmonë, bëjnë ruku dhe sexhde. Në çdo pëllëmbë të qiejve ka një melek i cili ose bën ruku, ose bën sexhde. Pra, ka melekë që vetëm Allahu ka njohuri rreth tyre, andaj ne besojmë në përgjithësi ata që nuk ua njohim emrat, dhe i besojmë në mënyrë specifike ata që ua njohim. Ne i duam ata, sepse janë krijesat më këshilluese dhe dashamire për njerëzit, sepse i urdhërojnë për mirë dhe kërkojnë falje për ta. Allahu i Lartësuar thotë:

الَّذِينَ يَحْمِلُونَ الْعَرْشَ وَمَنْ حَوْلَهُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيُؤْمِنُونَ بِهِ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِلَّذِينَ آمَنُوا

---

<sup>61</sup> Ez-Zukhruf: 77.

**“Ata (melekë), që e mbajnë Arshin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falenderim dhe i besojnë Atij. Ata kërkojnë falje për besimtarët.”<sup>62</sup>**

---

<sup>62</sup> Gafir: 7.

## DALLIMET MES PUNËVE TË MELEKËVE DHE PUNËVE TË SHEJTANËVE

**Dallimi i parë:** melekët e madhërojnë Zotin e tyre me falenderim, kërkojnë falje për ata që janë në Tokë, dhe janë krijesat më këshilluese dhe dashamire për njerëzit. Kurse shejtani është krijesa më mashtruese për njeriun, sepse shejtani është zotuar për humbjen e njeriut, për devijimin dhe shkatërrimin e tyre sa të ketë mundësi. Allahu azze ue xhel-le ka thënë:

إِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ

**“Vërtetë ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë.”**<sup>63</sup>

**Dallimi i dytë:** melekët i urdhërojnë njerëzit për mirë, kurse shejtanët i nxisin dhe urdhërojnë për keq. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَمَنْ يَعِشْ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُقِيضْ لَهُ شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ

**“Atij që shmanget nga përkujtimi i të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t’ia caktojmë një shejtan, që do t’i bëhet shok i pandashëm.”**<sup>64</sup> Vetëm përkujtimi i Allahut (dhikri) e mbron njeriun nga shejtani.

**Dallimi i tretë:** përkujtimi i Allahut (dhikri) i dëbon dhe largon shejtanët nga njeriu, kurse melekët prezantojnë tek ai. Për këtë, shejtani është quajtur cytës i cili fshihet pasi cyt. Nëse njeriu e

---

<sup>63</sup> El Earaf: 27.

<sup>64</sup> Ez-Zukhruf: 36.

lë përkujtimin e Allahut, i vjen shejtani, e nëse e përkujton Allahun, melekët e rrethojnë, sikurse thuhet në hadith: **“Çdo grup njerëzish që tubohen në një prej shtëpiave të Allahut, për të lexuar Librin e Allahut dhe që ta mësojnë atë mes tyre, vetëm se zbret qetësia mbi ta, mëshira i mbulon, melekët i rrethojnë, dhe Allahu i përmend me lëvdata tek melekët afër Tij.”**<sup>65</sup>

---

<sup>65</sup> Muslimi, edh-dhikru ued-dua uet-teubeh uel istighfar (2699); Tirmidhiu, el kiraet (2945); Ebu Daudi, es-salah (1455); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (225); Ahmedi (2/252).



## VENDET KU PREZANTOJNË MELEKËT

Ka melekë të cilët udhëtojnë nëpër Tokë, në kërkim të tubimeve ku përkujtohet Allahu. Nëse shikojnë një tubim ku përkujtohet Allahu, thonë: “Ejani tek ajo që po kërkoni!”

Përkujtimi i Allahut të Lartësuar është shumë llojesh, ku prej tyre është:

1- Leximi i Kuranit. Ai që lexon Kuranin, e përkujton Allahun e Lartësuar.

2- Ai që falet e përkujton Allahun.

3- Ai që thotë subhanAllah (i Lartësuar qoftë Allahu), që thotë estagfirUllah (kërkoj falje nga Allahu), që thotë Allahu ekber (Allahu është më i madhi) dhe thotë La ilahe il-lAllah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut), ky e përkujton Allahun dhe melekët tubohen tek ai, kurse shejtanët largohen.

4- Ata të cilët studiojnë në librat e Fesë, që ulen nëpër tubime dhe mësojnë fenë, ata e përkujtojnë Allahun dhe melekët tubohen tek ata.

## VENDET KU PREZANTOJNË SHEJTANËT

1- Ata të cilët angazhohen me dëfrim muzike dhe veglash muzikore, ata i përfshijnë dhe grumbullohen shejtanët, kurse melekët largohen prej tyre.

2- Ai që mban fotografi në shtëpinë e tij, nuk i hyjnë melekët, sikurse thuhet në hadith: **“Vërtetë melekët nuk hyjnë në një shtëpi ku ka qen apo fotografi.”**<sup>66</sup> Melekët e të Gjithëmëshirshmit nuk hyjnë në shtëpitë ku ka fotografi, qofshin ato të varura në mure, apo të ruajtura në korniza dhe albume kujtimesh, apo që përdoren për zbukurimin e mureve dhe shtëpive.

Këto fotografi janë fotografi frymorësh, ato i largojnë melekët dhe nuk hyjnë në këtë shtëpi ku ka të tilla fotografi. Mirëpo, fotografitë e lejuara janë atë që mbahen për domosdoshmëri, sikur letërnjoftimi, pasaporta dhe karta e identitetit; këto janë lejuar për domosdoshmëri. Këto nuk merren për t’u madhëruar dhe bëjnë përjashtim. Po ashtu (përjashtim bëjnë) edhe fotografitë të cilat shkelen dhe ulesh mbi to. Fjala është për fotografitë të cilat varen për përkujtim, që ruhen për t’u krekosur me to; këto janë ato që ndalohen, janë ato të panevojshmet, këto i afrojnë shejtanët nëpër shtëpia dhe ndalojnë nga hyrja e melekëve.

---

<sup>66</sup> Nesaiu, et-taharah (261); Ebu Daudi, et-taharah (227); Ibën Maxheh, el-libas (3650); Ahmedi (1/107); Darimiu, el ist’idhan (2663).

## NDIKIMI I BESIMIT NË MELEKË TEK JETA E NJERIUT

Besimi në melekë, ka ndikim madhështor në jetën e njeriut. Nëse njeriu e ndjen këtë gjë, atëherë ai do të ruhet. Nëse njoftohet se ka melekë të ngarkuar për të, të cilët ndërrohen natën dhe ditën për të, atëherë ai do të ruhet se mos t'i shkruajnë ndonjë gjë të papërshtatshme për të. Po të dinte se ka zbulues që e ndjekin, a nuk do të ruhej nga frika se mos t'i kapin ndonjë fjalë apo vepër që mund të dëmtohet nga pasojat e saj?!

Si mos të ruhet nga melekët të cilët nuk i sheh?! Njerëzit i shikon dhe ruhesh nga ai që të mbikqyr, ndërsa melekët të shikojnë dhe ti nuk i sheh. Prej njerëzve mund të ruhesh, mund të hysh në shtëpi, ose mund të ndrydhesh në një vend që nuk e dinë se ku je, mirëpo melekët hyjnë bashkë me ty në çdo vend. Allahu azze ue xhel-le u ka dhënë mundësinë të shkojnë në çdo vend që i ka urdhëruar, për këtë Allahu ka tërhequr vëmendjen dhe ka thënë:

وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ (10) كِرَامًا كَاتِبِينَ (11) يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ

**“Vërtetë mbi ju ka rojtarë (melekë që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.”**<sup>67</sup> Këtë e ka thënë Allahu azze ue xhel-le që të tregohesh i vëmendshëm.

Ky është fryti i besimit në melekë, se njeriu e ruan veten nga fjalët dhe veprat e këqija që i shkruhen dhe për të cilat jep llogari rreth tyre Ditën e Gjykimit.

---

<sup>67</sup> El Infitar: 10-12.

## ASGJË NUK I FSHIHET ALLAHUT TË LARTËSUAR

Allahu azze ue xhel-le ka thënë:

إِنْ كُلُّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ

**“Për çdo njeri ka mbikëqyrës.”**<sup>68</sup> Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

**“Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”**<sup>69</sup> A e dini se çfarë është damari? Damari i njeriut është ai që kalon nëpër qafë, në të cilin kalon gjaku. Një është djathtas dhe një majtas. Ata gjenden në qafë dhe në ta kalon gjaku që furnizon trupin.

Allahu thotë:

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

**“Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”**<sup>70</sup>

Sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ ۗ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

---

<sup>68</sup> Et-Tarik: 4.

<sup>69</sup> Kaf: 16.

<sup>70</sup> Kaf: 16.

**“Ai është i Pari dhe i Fundit, i Larti (dhe i Dukshmi me argumentet Tuaja) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i Dijshëm për çdo gjë.”<sup>71</sup>**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë në komentimin e kësaj: **“Ti je i pari, asgjë nuk është përpara Teje. Ti je i Fundit, asgjë nuk është pas Teje. Ti je i Larti (dhe i Dukshmi me argumentet Tuaja), asgjë nuk është mbi Ty. Ti je i Padukshmi (me sy), asgjë nuk t’i fsheh gjërat.”<sup>72</sup>**

Pra, asgjë nuk i fshihet Allahut azze ue xhel-le në tokë apo në det, brënda shtëpisë, në shkretëtirë, në treg, në xhami, në skenë, në vendet e defrimit, në çdo vend, në vendet e adhurimit apo të gjynahut. Asgjë nuk i fshihet Allahut dhe asgjë nuk mund t’i mbulohet. Për këtë, kur Xhibrili alejhis-salam e ka pyetur Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për Ihsanin, ai është përgjigjur: **“Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë, edhe pse ti nuk e sheh, vërtetë Ai të shikon ty.”<sup>73</sup>**

Nëse njeriu e ndjen se melekët janë bashkë me të dhe po ashtu e ndjen se Allahu thotë:

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ (16) إِذْ يَتَلَقَّى الْمُتَلَقِّيَانِ عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ قَعِيدٌ

(17) مَا يَلْفِظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ

---

<sup>71</sup> El Hadid: 3.

<sup>72</sup> Muslimi, edh-dhikru ued-dua uet-teubeh uel istighfar (2713), Tirmidhiu, ed-da’uat (3481), Ebu Daudi, el edeb (5051), Ibën Maxheh, ed-dua (3831), Ahmedi (2/536).

<sup>73</sup> Buhariu, tefsirul Kuran (4499); Muslimi, el iman (10), Nesaiu, el iman ue sheraiuhu (4991); Ibën Maxheh, el mukaddimeh (64); Ahmedi (2/426).

**“Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. Dy melekë i rrinë atij, njëri nga e djathta dhe njëri nga e majta, dhe për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”<sup>74</sup>**

أَمْ يَحْسَبُونَ أَنَّا لَا نَسْمَعُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ ۗ بَلَىٰ أَوْسَلْنَا لَدَيْهِمْ يَكْتُبُونَ

**“Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinzare dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (melekët) që janë pranë tyre, shënojnë.”<sup>75</sup>** Allahu dëgjon fjalët tinzare dhe bisedat e fshehta, ndërsa melekët shkruajnë dhe shënojnë. E gjithë kjo bën pjesë tek ndikimi që ka besimi në melekë.

---

<sup>74</sup> Kaf: 16-18.

<sup>75</sup> Ez-Zukhruf: 80.

## PËRKUJTOJI MELEKËT ME QËLLIM QË T'I DUASH ATA

Përkujtimi i melekëve nuk bëhet vetëm për aspektin e të njohurit me një gjë, sikur leximi i një historie apo të ngjashme. Mirëpo, melekët i përkujtojmë me qëllim që të përgatitemi dhe të ruhemi se mos na shënojnë diçka për të cilën Allahu i Lartësuar na merr në llogari, madje i përkujtojmë me qëllim që t'i duam ata, sepse Allahu i Lartësuar i don ata, dhe ne i duam sepse janë krijesat më të mira tek Allahu.

كِرَامٍ بَرَرَةٍ

**“Të mirët (të nderuarit tek Allahu) dhe të devotshmit.”<sup>76</sup>**

Me rëndësi është që ne të njohim vlerën dhe pozitën e melekëve, e t'i duam ata sepse Allahu i don. Sa i përket atij që i armiqëson dhe i urren melekët, atëherë Allahu është armik i tij, e atë që Allahu e armiqëson, ai është i humbur dhe ska të mirë për të.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِلَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَرُسُلِهِ وَجِبْرِيلَ وَمِيكَالَ فَإِنَّ اللَّهَ عَدُوٌّ لِلْكَافِرِينَ

**“Kush është armik i Allahut, i melekëve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe Mikailit, ta dijë se Allahu është armik i jobesimtarëve.”<sup>77</sup>** Kush i armiqson melekët, atëherë Allahu është armik i tij.

---

<sup>76</sup> Abese: 16.

<sup>77</sup> El Bekare: 98.

E lus Allahun azze ue xhel-le të na japë ne dhe ju besim të  
singhtë, dituri të dobishme dhe vepra të devotshme.

Salavatet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë  
Muhamed, familjen dhe shokët e tij.



## PËRMBAJTJA E LIBRIT

<b>Hyrje</b> .....	3
<b>Domethënia e besimit në melekë</b> .....	6
<b>Nga çfarë janë krijuar melekët?</b> .....	7
<b>Cilësitë e melekëve</b> .....	8
<b>E para:</b> ata janë ushtria më madhështore e Allahut.....	8
<b>E dyta:</b> fizionomia e tyre është madhështore.....	10
<b>E treta:</b> melekët kanë fuqi shumë të madhe me lejen e Allahut.....	11
<b>Punët me të cilat janë ngarkuar melekët</b> .....	14
<b>Së pari:</b> ka prej tyre që kujdesen për Xhehenemin.....	14
<b>Së dyti:</b> ka prej melekëve që janë të ngarkuar me bartjen e Arshit.....	14
<b>Së treti:</b> ka prej tyre që janë të ngarkuar me Shpalljen.....	15
<b>Së katërti:</b> ka prej melekëve që janë të ngarkuar me punë të tjera.....	19
<b>Së pesti:</b> ka melekë të ngarkuar me fetusin në barkun e gruas.....	21
<b>Së gjashti:</b> ka melekë të ngarkuar me marrjen e shpirtrave.....	21

<b>Së shtati:</b> ka melekë që janë të ngarkuar me shënimin dhe ruajtjen e veprave të njeriut.....	23
<b>Së teti:</b> ka melekë që janë të ngarkuar me mbrojtjen e njeriut nga rreziqet.....	26
<b>Së nënti:</b> ka melekë që janë të ngarkuar në këtë Gjithësi me punë që i di vetëm Allahu.....	27
<b>Obligueshmëria e besimit në melekë dhe në gjithë punët e tyre.....</b>	<b>28</b>
<b>Dallimet mes punëve të melekëve dhe punëve të shejtanëve.....</b>	<b>30</b>
<b>Vendet ku prezantojnë melekët.....</b>	<b>32</b>
<b>Vendet ku prezantojnë shejtanët.....</b>	<b>33</b>
<b>Ndikimi i besimit në melekë tek jeta e njeriut.....</b>	<b>34</b>
<b>Asgjë nuk i fshihet Allahut të Lartësuar.....</b>	<b>35</b>
<b>Përkujtoji melekët me qëllim që t'i duash ata.....</b>	<b>38</b>